



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:254510

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844847

KP.nr. 15/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit KS “Delta Security” me seli Dëshmorët e Kombit D1 H/6, 10.000 Prishtinë, të cilin e përfaqëson Avokat Arbër Jupolli me seli në Prishtinë, kundër të paditurit KS “Besa Security” Sh.p.k me seli në rrugën Mark Isaku Prishtinë, të cilin e përfaqëson Av. Ylli Zekaj me seli në Prishtinë, me objekt kontesti pengim në realizimin e kontratës, pas mbajtjes së seancës përgatitore më datën 12.06.2024, ndërsa më datën 21.06.2024 merr këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia –

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e KS “Delta Security” me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri KS “Besa Security” Sh.p.k të tërheqë barakën e cila është vendosur në brendi të tregut të gjelbër tek amortizerat, dhe të ndërpret patrullimin në zonën e tregut të gjelbër, pjesë e lokaleve me tekstil, hekrari dhe hoteleri e cila për ruajtje i është besuar kompanisë delta security.
- II. Detyrohet paditësi që të paditurit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 175,50 €, në afatë prej 7 ditësh nga dita kur aktgjykimi mer formën e prerë.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 03.10.2007 në Gjykatën Komunale në Prishtinë ka ushtruar padi ndaj të paditurit me kërkesë të tërheqë barakën e cila është vendosur në brendi të tregut të gjelbër tek amortizerat, dhe të ndërpret patrullimin në zonën e tregut të gjelbër, pjesë e lokaleve me tekstil, hekrari dhe hoteleri e cila për ruajtje i është besuar kompanisë delta security.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën përgatitore me datën 12.06.2024, ku prezentë ishin të autorizuarit e palëve në procedurë, i autorizuari i paditësi paraprakisht përmes parashtresës të

datës 10.06.2024 ka heqë dorë nga kërkesë-padia pasi që paditësi nuk ka interes juridik lidhur me objektin e kërkesëpadisë prandaj dhe heqë dorë nga kërkesëpadia duke i propozuar gjykatës që të merr aktgjykim kondromë nenit 149 par. 1 të LPK-së. Ndërsa në seancën e mbajtur i njëjti ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë parashtrësës për heqjeje dorë nga kërkesë padia .

I padituri në seancën përgatitore ka deklaruar: nuk e kundërshton deklarin dhe propozimin e të autorizuarit të paditësit, ndërsa shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Sipas dispozitës së nenit 149.1, të LPK-së, përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heq dorë nga një pjesë e kërkesë padisë apo nga e gjithë kërkesëpadia gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykim në bazë të heqjes dorë)”*, ndërsa me pikën 2, të po të njëjtit nen shprehimisht përcaktohet *“për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës se paditur”*.

Bazuar në deklarinimet e të autorizuarit të paditësit se heqë dorë nga kërkesë padia dhe tërhiqet nga padia në tërësi sa i përket pengim në realizimin e kontratës.

Gjykata në mbështetje të dispozitës se nenit 149, lidhur me nenin 388, të LPK-së, gjeti se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore që gjykata të bie aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga i padituri dhe atë: për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 100.00 €, dhe për përfaqësime në një seancë shumën prej 67.50 €, ë shumë të përgjithshme prej 175.50€

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.15/24, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.